

Qendra Nderkombetare e Referimit per Mbrojtjen e Minoreve ne Biresim – Gjeneve.

Sherbimi Social Nderkombetar
Seksioni Italian

**TE DREJTAT E FEMIJEVE NE BIRESIMIN
KOMBETAR DHE NDERKOMBETAR**

BAZA ETIKE – ORIENTIME PRAKTIKE

Te drejtat e femijeve ne biresimin kombetar dhe nderkombetar

Hyrje

Pasi kane kaluar dhjete vjet nga shpallja e Konventes se Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Femijeve, Sherbimi Social Nderkombetar i propozon kete dokument bashkebiseduesve te rrjetit te Qendres se saj Nderkombetare e Riferimit per Mbrojtjen e Minoreve ne Biresim (SSI/CIR), dhe te gjithë atyre qe nderhyjne ne favor te te drejtave te femijeve. Ky dokument trajton biresimet kombetare dhe nderkombetare. Nese disa principe dhe praktika te permendura kane te bejne me teper me biresimin nderkombetar, megjithate mbrojta e minoreve duhet te jete objektivi kryesor ne te dyja sektoret e nderhyrjes.

- Kemi konsideruar te domosdoshem percaktimin e **principeve etike**, mbi te cilat duhet te mbeshtetet biresimi, pasi ai eshte nje vendim i rendesishem per jeten e qenieve te ndryshme njerezore, dhe midis tyre te nje minori ne kondita cenueshmerie.
- Edhe pse parimet etike jane te konceptuara si nje mjet referimi te pavarur, kemi quajtur te rendesishme te shenojme **disa orientime shtese me qellim edhe praktika te respektoje etiken**. Keto jane rezultate shkembimi me operatore profesionale nga e gjithë bota dhe reflektojne e kompletojne udhezimet e dhena ne Konventen per te Drejtat e Femijeve te 1989 dhe ne Konventen e Hages per Mbrojtjen e Femijeve dhe bashkepunimi ne fushen e biresimit nderkombetar te 1993 . Shpresojme t'i pasurojme ato me tej me publikime te tjera ne te ardhmen.

Urojme qe kjo broshure t'ju nevojitet ne punen e perditshme dhe nese eshte e mundur ne te ardhmen ta permiresojme e ta kompletojme me kontributin tuaj. Na shkruani per te marre pjese me eksperiencat tuaja, me aspektet qe jeni dakort dhe ato qe nuk mbeshtetni. Na njihni me dokumenta te tjere qe kane te njejtat objektiva me broshuren tone.

Gjeneve, nentor 1999
Sekretariati i Pergjithshem i SHSN-se
Qendra Nderkombetare e Riferimit per Mbrojtjen e Femijeve ne Biresim

PERMBAJTJA

- 1. PARIMET ETIKE**
- 2. DISA ORIENTIME ME QELLIM QE PRAKTIKA TE RESPEKTOJE ETIKEN.**
 - Biresueshmeria e femijes
 - Aftesia per biresim e nje familje
 - Bashkimi
- 3. SUBJEKTE TE PERFSHIRA DIREKT NE PROCESIN E BIRESIMIT.**

PARIMET ETIKE

I. BIRESIMI: NJE MASE SOCIALE DHE LIGJORE PER MBROJTJEN E FEMIJEVE

- a) **Biresimi nuk eshte nje marreveshje midis subjekteve private.** Eshte nje mase ligjore e sociale per mbrojtjen e femijeve. Duhet parashikuar dhe autorizuar vetem me kete qellim. Shtetet jane pergjegjes te kontrollojne qe kjo gje te zbatohet.
- b) Kjo gje duhet parashikuar per te gjithë femijet te cileve i ua kerkon situata familiare e personale, pa paragjykime per konditat sociale, te shendetit fizik dhe mendor, te races, etnise dhe te kultures.

II. INTERESI KRYESOR DHE TE DREJTAT THEMELORE TE FEMIJES

Te gjitha masat mbrojtese te marra ne favor te femijeve duhet te drejtohen ne kerkimin e interesit me te mire te tij dhe te respektimit te te drejtave themelore.

Kjo nenkupton qe:

- a) **Femija duhet te jete pike fillimi i nisjes se procedures se biresimit te tij.** Kjo procedure vihet ne zbatim sepse e kerkon vete situata e minorit dhe jo sepse disa persona shprehin deshiren per ta biresuar ate ose jane ne kerkim te nje femije.
- b) Zhvillimi i rastit te secilit femije nuk mund ti besohet prinderve biologjike, mediatoreve jo te kualifikuar ose me nje etike profesionale te diskutueshme, ose prinderve te mundshem birsues. Ai duhet t'i besohet **sherbimeve kompetente ne sektorin e mbrojtjes se femijeve**, mundesisht te jene multidisiplinare, te njohura, e nje supervizimi periodik nga ana e autoriteteve kombetare kompetente.

Biresimi i drejteperdrejte nga nje familje ne nje tjetër duhet te ndalohet, perveç rasteve shume te veçanta te supervizionuara nga sherbimet e mbrojtjes se femijes.

- c) Operatoret profesionale qe nderhyjne ne proceduren e biresimit duhet qe ne konceptimin e tyre te punes dhe ne praktike te jene te drejtuar kryesisht nga nevojat e femijes. Nese duhet te jene te kujdesshem duke mbajtur nje qendrim te vemendshem dhe respektues kundrejt kerkesave te prinderve te ardhshem biresues, ose nevojave te familjes biologjike, ciladoqofshin karakteristikat e tyre, ata nuk duhet te pergjigjen me perparesi, por te vleresojne se ne cfare pike i pergjigjen interesit me te mire te femijes. Operatoret profesionale duhet te jene te ndergjegjeshem qe biresimi ne interes te minorit eshte ai qe lejon te krijohet nje situatë ose raporte familjare te kenaqshme per te gjithë personat e perfshire.
- d) Duke marre parasysh qe koha ka nje rendesi shume te madhe ne zhvillimin e minorit, operatoret profesionale duhet te **veprojne sa me shpejt te jete e mundur** por jo qe kjo te çojë ne shkeljen e procedurave. Ata do te shkurtojne, persa te jete e mundur periudhen e situatave ne pritje, te pasigurta ose tranzicioni ne te cilat jetojne femijet.
- e) **Femija**, sipas moshes dhe nivelit te pjekurise, **duhet te jete i informuar dhe i konsultuar** mbi te gjitha projektet e jetes qe i perkasin.

Nga sa u paraqit me lart aplikohet si ne biresimin kombetar ashtu dhe ne ate nderkombetar.

III. PRIORITETET PER PARANDALIMIN E BRAKTISJES

Prioriteti duhet dhene per t`i lejuar femijes te rritet ne gjirin e familjes se tij. Qendrimi me prinderit biologjik ose me fisin (parandalimi i braktisjes); reintegrimi ne familje ose ne fis (femije ne situata te para-braktisjes). Qeverite dhe shoqerite civile duhet te perkushtohen ne maksimum qe familjet e origjines te kene mundesine te kujdesen per femijet e tyre dhe te inkurajohen per kete.

Kjo kerkon formulimin e politikave dhe te programeve qe marrin parasysh zhvillimin njerezor dhe drejtesine sociale dhe qe perkthehen ne: mbeshtetje psiko-sociale ose financiare per nenat dhe familjet ne veshtiresi, nderhyrje sociale prane fisit dhe ne vecanti gjysherit qe te bashkepunojne per te shmangur braktisjen.

Pervec kesaj te kujdesen per sensibilizimin, rendesine e rolit prinderor, formimin prinderor, ndergjegjien e nevojave dhe te drejtave te femijeve, edukimin seksual dhe nje planifikim familjar te ndergjegjshem dhe te pergjegjshem, promovimin dhe respektimin e te drejtave te gruas. Ne nje plan te pergjithshem te behen politika qe parashikojne rroga te barabarta, qe mbeshtesin papunesine, dhe per uljen e çekuilibrimit ekonomik boteror.

II. KERKIME PER ALTERNATIVA

Kur familja e origjines nuk ofron konditat minimale per te garantuar zhvillimin psiko-social dhe integritetin fizik e emotiv te minorit, organizmat kompetente ne fushen e mbrojtjes se femijeve duhet te kerkojne zgjidhje te pershtatshme. **Varferia ne vetvete nuk duhet te jete nje arsye e mjaftueshme per te vendosur nderprejen e lidhjeve te femijes me familjen e origjines.** Por duhet bere kujdes qe ajo nga ana tjeter te mos behet nje kriter per t'i refuzuar nje femije alternativen e nje familje zevendesuese qe respekton te drejtat dhe nevojat e tij.

V. PRIORITETET PER ATERNATIVAT FAMILJARE

Familja eshte ambjenti ideal per zhvillimin e minorit: **t'i ofrosh nje minori nje familje zevendesuese, pervec rasteve te veçanta dhe te justifikueshme, duhet te preferohet me teper se sa vendosja ose rritja per kohe te gjate ne nje institut.** Eshte pergjegjesi e autoriteteve kompetente te kontrollojne qe femijet te mos rrijne ne institute pa analizuar shpejt situaten e tyre familiare e personale dhe te gjenden masat e pershtatshme te mbrjotjes se tipit familjar.

VI. PRIORITETET PER ZGJIDHJET E PERHERSHME

Per t'u zhvilluar minori ka nevojë per nje lidhje te qendrueshme me te rriturit me te cilet ka lidhje: **zgjidhjet e perhereshme duhet te preferohen ndaj zgjidhjeve te perkohshme dhe ne kohe te papercaktuar.**

VII. PARIMI I NDIHMES NE BIRESIMIN NDERKOMBETAR

Biresimi nderkombetar eshte ndihmes per biresimin kombetar. Femija ne menyre primare duhet dhene per biresimin ne vendin e tij ose ne nje ambient kulturor, gjuhesor dhe fetar te ngjashem me ate te origjines. Vendimi per nje biresim nderkombetar duhet marre vetem pasi te jete kerkuar, pa asnje rezultat, nje zgjidhje e kenaqshme per minorin ne vendin e tij te origjines. Ne interes te minorit autoritetet kompetente do te kontrollojne qe ky kerkim te behet **pa vonesa te pajustificueshme.**

VIII. BIRESUESHMERIA E FEMIJES

Biresimi eshte nje projekt personal per jeten e femijes. Ky projekt nuk do te vihet ne zbatim pa u nisur nga nje studim i meparshme psiko-mjeko-social te femijes dhe te familjes se tij te origjines. Kontastimi qe familja e origjines e ka te pamundur te marre persiper kujdesjen e minorin dhe vleresimin e aftesive te minorit per t'u integruar pozitivisht ne nje ambient familjar, percakton **biresueshmerine e tij psiko-sociale.** Kjo eshte e kompletuar nga **biresimi i tij juridik** qe vendos nderprejten e lidhjeve birnore me familjen e origjines ne format e parashikuara nga legjislacioni kombetar.

Biresueshmeria e femijes duhet te vendoset perpara se te ndermerret procesi i biresimit.

IX. AFTESIA PER BIRESIM E PRINDERVE TE ARDHSHEM

Biresimi ka per qellim te ofroje familjen me te pershtatshme, duke iu pergjigjur nevojave te saj, nje minori qe ka perjetuar situata traumatizuese (paaftesi ose pamundesi e familjes se tij te origjines per tu perkujdesur edhe pse i perket asaj) e nganjehere eshte mbartes ndryshimesh kundrejt shoqerise qe do te prese. **Familja biresuese duhet pra te jete paraprakisht e njohur si e kualifikuar** dhe e pershtatshme per te siguruar, ne menyre te qendrueshme dhe te vazhdueshme, mbrojtjen dhe respektin e nje femije me kete te kaluar dhe me keto karakteristika. Nje studim psiko-mjeko-social i nje familje te tille duhet pra realizuar **para se te ndermerret praktika e biresimit**. Ky studim duhet per te konfirmuar ose per te mohuar aftesite biresuese te familjes, **aftesi keto qe duhet te jene objekt i nje vertetimi zyrtar**.

Ne rastin e **biresimit midis familjaresh**, aftesite biresuese te biresuesve duhet te jene njekohesisht objekt i nje studimi e nje vertetimi.

X. PERGATITJA PER BIRESIM

Femija, familja biresuese dhe familja biologjike duhet te pregatiten per biresimin. Nje biresim do t'i pergjigjet interesave te te gjithe personave te perfshire, nese nje pergatitje e duhur do t'i lejoje secilit te kuptoje cilat do te jene nderlikimet, afatshkurter dhe afatgjate, te biresimit ne jeten e secilit. Pervec kesaj pergatitja duhet te ndihmoje minorin dhe familjen biresuse per te perballuar me qetesi takimin dhe fazen e pare te jetes se bashku.

XI. MBESHTETJA PAS BIRESIMIT

Kerkesa per ndihme prane sherbimeve te kualifikuara te mbeshtetjes pas biresimit duhet te behet e mundur per minoret, per prinderit biresues, per motrat dhe vellezerit, ashtu dhe per prinderit biologjike me qellim qe te pergjigjen per problemet e mundshme te metejshe dhe te sqarohen ose te zgjidhen problemet qe mund te identifikohen.

XII. E DREJTA PER KONFIDENCIALITET

Minori, prinderit biologjike dhe famiglia biresuese kane te drejten e konfidencialitetit dhe te respektimit te jetes se tyre private. **Aksesi ne dokumentat e tyre do te jete i mire percaktuar.** Ne se do te gjykohet e nevojshme, ne interesin me te mire te femijes, publikimi i informazioneve personale do te perhapet, me menytrat qe do te konsiderohen te pershtatshme, **prane personave te seleksionuar** per aftesine e tyre ose per interesin e treguar ne propozimin e zgjidhjeve, por nuk do te lejohet aksesi i nje publiku te gjere te pidentifikuar ne mjete komunikimi si interneti.

XIII. KERKIMI I ORIGJINES

Nese shihet e rendesishme dhe kur mosha dhe niveli i pjekurise e lejojne, **minori ka te drejte** te njohe historine e tij dhe ne veçanti, nese eshte e mundur, te dhena mbi babain dhe nenen biologjike. **Eshte e rendesishme te garantohen mbledhja dhe ruajtja e ketyre informacioneve. Perveç kesaj kerkimi i origjines duhet te shfrytetoje nje mbeshetje psiko-sociale te kualifikuar.** Prandaj per te organizuar keto nderhyrje duhet te krijohen ose te forcohen sherbime profesionale te specializuara.

Ne kontekstin social aktual te disa vendeve mund te jete e veshtire te respektohet kjo e drejte. Megjithate, duke marre ne konsiderate shtimin e kerkesave per kerkimin e origjines nga te rinj dhe te rritur te biresuar, çdo shtet duhet te perkushtohet maksimalisht per te permiresuar punen e tij ne zbatimin e kesaj te drejte.

XIV. PERFITIME JO TE LIGJSHME – ABUZIME – TRAFIK – SHITJE

Mbrojtja e femijes ne kushte te veshtira nuk duhet te jete nje burim perfitimesh materiale ose te tjera. Te gjitha abuzimet, tregetimet ose trafiket ne kete fushe shkelin te drejtat e njeriut dhe per kete arsye duhen luftuar dhe ndeshkuar ne menyre te rrepte.

XV. KONFLIKTET E ARMATOSURA – KATASTROFAT NATYRORE

Biresimi nderkombetar eshte nje mase qe nuk duhet te parashikohet ne vendet ku ka konflikt te armatosur ose per viktimat e nje katastrofe natyrore. Ky nuk mund te merret ne konsiderate vetem pas nje periudhe mjaftueshmerisht te gjate (ne pergjithesi keshillohet nje periudhe te pakten dy vjecare) per t`i lejuar organizmave te sigurohen qe asnje pjestar i familjes o i komunitetit te femijes deshiron dhe eshte ne gjendje ta marre nen mbrojtjen e tij. Gjate pritjes i duhet dhene prioritet sigurise se femijes dhe masave ndihmese ne vende per te favorizuar qendrimin e minorit ne komunitetin qe i perket dhe mundesisht ne vendin e ne rajonin e tij.

DISA ORIENTIME ME QELLIM QE PRAKTIKA TE RESPEKTOJE ETIKEN

*Keto orientime perbejne nje **kuader referimi**. Jemi te ndergjegjshem qe do te paraqiten pengesa te shumta per aplikimin e tij. Megjithate urojme qe te jete e nevojshme per te avancuar drejt nje praktike me te respektuar te femijeve. Pervec kesaj keshillojme qe aplikimi i saj te rregullohet ne menyre qe te marre parasysh vecanerisht situaten dhe interesin primar te cdo minori. Disa vende te origjines mund te ndeshen ne veshiresi per te vene ne dispozicion burime njerezore dhe materiale te nevojshme. Vendet e pritjes duhet t'i ndihmojne qe te kene mundesi per te perballuar pergjegjesite e tyre.*

Te zbatosh te drejtat e femijeve ne fushen e biresimit eshte nje pergjegjesi jo vetem e vendeve te pritjes por dhe te atyre te origjines. Vetem nje bashkepunim i vertete midis tyre do te mundesoje permiresimin e mbrojtjes se femijeve.

BIRESUESHMERIA E MINORIT

BIRESUESHMERIA

1. Percaktimi i **biresueshmerise i nje te mituri ka te beje jo vetem me femijen por edhe me familjen e tij biologjike**:nene, baba, fis, dhe ne disa raste komuniteti i tij.
2. Biresueshmeria e nje minori duhet te vendoset **perpara** se te parashikohet nje bashkim i caktuar.
3. **Biresueshmeria** nuk eshte nje situatë ekskluzivisht juridike. Ajo **duhet te marre parasysh disa elemente psikologjike, sociale, mjeksore e juridike**.
 - 3.1.Ajo percakton nese minori ka nevoje per nje familje biresuese, sepse nuk mund te qendroje ose te rifutet ne familjen e origjines.
 - 3.2.Ajo percakton nese minori eshte ne nje situatë psikologjike e mjeksore te tille per te perfituar nje biresim.

Per shkak te jetes se tyre te meparshme, disa minore mund te mos kene me deshiren per te vendosur nje lidhje afektive biresore ose paraqisin problematika serioze ne pershtatjen e tyre ne nje ambjent e ri familjar. Megjithate pjesa me e madhe e femijeve eshte ne gjendje te perfitoje nga vendosja ne nje ambjent familjar te perhershem. Disa nga keta femije, duke patur karakteristika te vecanta (zhvillimim te vonet fizik ose mendor, trauma psikologjike te renda, semundje etj...) kane nevojte per nje ambjent familjar biresues qe permban karakteristika te vecanta per t' i dhene mundesine e nje rekuperimi fizik, afektiv ose psikik. Sigurisht, ekzistojne familje te afta dhe qe kane deshire t'i ofrojne ketyre femijeve hapesiren humane te pershtatshme. Eshte themelore shmangia e diskriminimit te kesaj kategorie femijesh dhe te punohet maksimalisht per t'i ofruar atyre avantazhet e nje biresimi.

3.3. Biresueshmeria percakton nese minori eshte ligjerisht i biresueshem.

STUDIM PER MINORIN DHE FAMILJEN E TIJ TE ORIGJINES

4. Biresueshmeria duhet te percaktohet mbi bazen e **studimeve psiko-mjeko-sociale per minorin dhe familjen e tij te origjines.**

4.1. Eshte e nevojshme te vepohet ne menyre te shpejte per realizimin e studimeve mbi biresueshmerine e nje minori. **Nga momenti qe minori hyn ne nje institut** (spital, martenitet, qender pritesese e perkohshme ose e perhershme), **situata e tij duhet te analizohet.** Kjo gje do te shmang demet e shkaktuara nga qendrimi i gjate dhe i kote i minorit ne nje institucion. Kjo do te mundesoje shpjegimin e situatave te paqarta dhe tranzitore qe mund te paragjykojne zhvillimin e minorit.

4.2. Per keto studime psiko-sociale duhet te ngarkohen **profesioniste ne fushen e mbrojtjes se minoreve.**

4.3. Nga momenti qe minori eshte i vendosur ne nje institucion, me qellim per te ruajtur kujtimet e shkuara te minorit dhe te familjes do te ishte i vlefshem krijimi i **"librit te jetes"** per te mbledhur historine dhe detajet e zhvillimit te minorit. Ky liber i jetes do te jete pjese i dokumentave qe me vone do t'i dorezohen familjes qe do te kujdeset per minorin.

5. Studimi duhet te jete sa me i detajuar sepse prej tij varen e ardhmja e femijes, e familjes se tij biologjike dhe familjes se mundshme zevendesuese. Ky studim teper konfidencial duhet te perqendrohet mundesisht mbi:

5.1. Identiteti i minorit, i prinderve te tij dhe i familjes se zgjeruar; nese prinderit jane te panjohur duhet te behen kerkime per t'i identifikuar dhe te diskutohet me ta e ardhmja e femijes.

5.2. Situata e familjes se minorit: perberja familjare(prinderit, vellezerit e motrat) dhe fisi (gjysherit, xhaxhallaret, hallat, dajat, tezet etj...), situata socio - ekonomike, raportet familjare, marredheniet me ambjentin social, problemet paresore, elemente te favorshem, etj.

5.3. E kaluara e femijes: te merren te gjitha informacionet e mundshme mbi etapat e historise se tij personale dhe familjare, mbi paraardhesit e tij etnike dhe fetare.

5.4. Shkaqet e prishjes se marredhenieve te femijes me familjen e tij te origjines, te deklarates se braktisjes ose te aprovimit te biresimit.

5.5. Etapat e zhvillimit fizik, mendor dhe socio-emocioal te minorit.

5.6. Situata shendetesore, historia e tij mjekesore (perfshire informacione te disponueshme mbi shtatezanine e nenes, lindja, vaksinimet etj.) dhe ajo e familjes se origjines.

5.7. Aspekti i tij fizik dhe i pergjithshem, personaliteti dhe sjellja e tij.

5.8. Jeta aktuale e minorit: te merren te gjitha informacionet e mundshme mbi jeten e tij, menyren e jeteses, zakonet, aftesite e te qenit autonom, marredheniet me femijet e tjere dhe te rriturit qe e rrethojne, ritmet e tij te jeteses etj.

6. Eshte e nevojshme te sigurohet gjithmone qe gatishmeria e minorit nuk eshte rezultat i nje trafiku, abuzimesh, shitje ose rrembimi.

6.1. Eshte e nevojshme **te percaktohet qartesisht origjina e minorit.**

6.2. Kur pas leshimit te aprovimit te prinderve, femija rezulton i biresueshem eshte e nevojshme te verifikohet qe ky aprovim eshte leshuar lirisht, pa presione, pa shperblime materiale ose te tjera. Sherbimet sociale duhet te orientojne dhe te ndihmojne prinderit per e parashikuar per femijet e tyre alternativa te ndryshme nga biresimi.

Ato duhet te informojne prinderit dhe te sigurohen qe ata kane kuptuar mire pasojat e biresimit, qe mund te jete edhe nderkombetar. Pervec kesaj prinderit duhet te kene te qarte nderlikimet per minorin dhe per vete ata, ndryshimet ne raportet e tyre ligjore dhe marredheniet reciproke interpersonale. Eshte e nevojshme qe prinderit te informohen mbi mundesine e nje rivendosje lidhjesh ne te ardhmen, ne rastin kur femija tashme ne moshe

madhore deshiron te rifilloje kerkimin e origjines. Eshte e nevojshme qe familja zevendesuese te marre parasysh deshirat e mundshme te prinderve biologjike, nese keto korrespondojne me interesin e minorit.

6.3. Aprovimi i prinderve (te nenes ne veçanti) nuk duhet te jepet as para lindjes, as ne javet e para te jetes se femijes.

Babait dhe nenes i duhet dhene mundesia per te vendosin marredhenie me femijen t'ju lihet nje periudhe reflektimi pas lindjes. Ne kete periudhe dhe gjate shtatezanise, eshte shume e rendesishme t'iu sigurohet prinderve nje mbeshtetje psiko-sociale dhe ekonomike per te ulur rreziqet dhe ne rastin kur kjo gje konfirmohet, per t'i ndihmuar te ndahen ne menyre korrekte nga femija i tyre.

PERCAKTIMI I NJE PROJEKTI PER JETEN E MINORIT

7. **Studimet** e kryera nga nje ekip profesional ne fushen e mbrojtjes se minoreve dhe mundesisht multidisiplinar, **duhet te arrijne ne percaktimin e nje projekti per jeten e minorit**. Ky projekt jete eshte masa (ose nje sere masash) per mbrojtjen sociale me te pershtatshme per ate femije. Nje nga keto masa mund te jete dhe biresimi.
8. Projekti per te ardhmen e femijes duhet te mbeshtetet **ekskluzivisht ne interesin e tij**.
 - 8.1. **Çdo minor eshte nje qenie unike** dhe projekti duhet ta konsideroje te tille.
 - 8.2. Projekti duhet te organizohet mundesisht me pjesmarrjen e babait dhe te nenes biologjike te minorit.
 - 8.3. Projekti duhet te konceptohet, te zbatohet, dhe te plotesohet me pjesmarrjen e femijes ne funksion te moshes dhe nivelit te tij te pjekurise.
 - 8.4. Projekti duhet te garantoje qe **nuk duhet te ndahen vellezer e motra** te nje gjaku (ose ne rast lidhjeje afeksioni), vecanerisht kur keta njihen; nese ne raste te rralla ndodh e kunderta, projekti duhet te parashikoje ruajtjen e marredhenieve ne kohe.
 - 8.5. Biresimi duhet te zgjidhet si projekt jete vetem ne rastin kur, panvaresisht nga perpjekjet e bera, qendrimi ose reintegrimi i minorit **ne perberjen famijare te origjines ose ne familjen** e zgjeruar (fis), shihen te pamundur ose ne kundersizim me interesin e vete minorit.

8.6. Biresimi duhet te konsiderohet si nje mase e duhur vetem ne rastin kur rezulton i **pershtatshem me karakteristikat personale te femijes.**

8.7. **Biresimi nderkombetar** i femijes duhet te merret ne konsiderate vetem kur nga njera ane, panvaresisht nga perpjekjet ne kete aspekt, minori nuk ka mundur te perfitoje nga biresimi i nje familje te vendit te tij te origjines, dhe nga ana tjeter biresimi nderkombetar eshte me i pershtatshem per karakteristikat personale te femijes (aftesi pershtatje ne nje kontekst familjar, social, etnik, kulturor, gjuhesor, shkollor, te karakteristikave te ndryshme fizike etj.)

8.8. Vetem ne raste te vecanta **kur per te miturit eshte i pamundur reintegrimi ne familjen e origjines, biresimi duhet te preferohet kundrejt institucionalizimit me kohe te papercaktuar** pa paragjykime etnike, te karakteristikave fizike, te moshes, te problemeve te shendetit fizik ose mendor.

8.9. Nese biresimi percaktohet si projekt i jetes se minorit, **duhet te vendoset ne menyre te qarte** dhe te zyrtarizohet **bireshmeria ligjore e tij.**

RAPORT MBI MINORIN ME QELLIM PER TE PROCEDUAR BIRESIMIN E TIJ

9. Duke u nisur nga studimet e meparshme do te pregatitet nje raport mbi minorin i cili i duhet te dorezohet organizmave te pergjegjshem per bashkimin dhe biresimin.

Ky raport duhet te jete nje pershkrim i kompletuar i femijes dhe i familjes se tij te origjines me qellim per te ndihmuar organizmat kompetente te realizojne bashkimin qe i korrespondon me shume interesave te femijes dhe te familjes qe do ta biresoje.

Pervec kesaj, fale ketyre elementeve qe do te transmetohen ne "librin e jetes" familja biresuese mund te njohe minorin dhe jeten e tij te meparshme me qellim per ta kuptuar me mire, pritur dhe shoqeruar ne jeten e tij. Ne kete menyre familja biresuese mund t'i pergjigjet me qartesisht pyetjeve qe minori mund te beje mbi historine e tij.

Ky raport do te permbaje mundesisht:

9.1. Shkaqet per te cilat biresimi eshte masa mbrojtjese e propozuar. Nese behet fjale per biresim nderkombetar duhet te paraqiten shkaqet specifike qe e justifikojne.

9.2. Nje sintheze e informacioneve psiko-sociale te mbledhura gjate studimit per minorin dhe familjen e tij biologjike.

9.3.Raportin mjekesor mbi anamnezen, gjendjen shendetesore te minorit dhe te paraardhesve te tij familjare.

9.4.Praktikat ligjore mbi biresueshmerine e tij.

9.5.Pershkrimin e situates se tij jetesore aktuale, te zakoneve, te marredhenieve, te sjelljeve te tij.

9.6.Vleresimin e elementeve pozitive dhe te risqeve ekzistuese ne personalitetin e tij, e jetes se meparshme, dhe karakteristikave te minorit me qellim qe te vendoset nje marredhenie biresuese e kenaqshme.

9.7.Nje udhezim orientues mbi llojin e famijles qe mund te korrespondoje me nevojat e minorit dhe te lehtesoje hyrjen ne gjirin e saj dhe ne brendesi te shoqerise se ciles ajo i perket: perberja familjare, karakteri, mosha etj.

9.8.Te gjitha informacionet e tjera qe mund te ndihmojne ne realizimin e nje bashkimi ne interes te femijes dhe te familjes biresuese.

9.9.Foto te minorit ose ndonje videokasete.

10. **Informacionet mbi origjinen e minorit duhet te ruhen nga nje prej organizmave pergjegjes per biresimin.** Nese me vone i biresuari do ta ndjeje te nevojshme, dhe n.q.se mosha dhe pjekuria e tij do ta lejojne, keto informacione mund t'i komunikohen nepermjet nje mbeshtetjeje psiko-sociale duke respektuar te drejtat e familjese se origjines dhe legjislacionet e vendeve te perfshira. **Vendosja e marredhenieve me familjen biologjike duhet te jete objekt i nje shoqerimi te specializuar psiko-social per familjen biologjike dhe per te biresuarin,** dhe do te kryhet vetem nese pranohet nga te dyja palet dhe do te rezultojte qe jane ne gjendje te marrin persiper pasojat. CIR/SSI rekomandojne qe rivendosja e marredhenieve te merret ne konsiderate vetem pasi biresuesi te kete kaluar moshen e adoleshences. Te gjitha nderhyrjet duhet te respektojne konfidencialitetin qe i perket cilido personi te perfshire ne kete proces.

AFTESIA E FAMILJEVE PER BIRESIM

OPINIONI I SHERBIMIT SOCIAL NDERKOMBETAR

11. Biresimi duhet te jete nje takim midis femijes me nevojat e tij e prinderve biresues me deshiren e tyre. Kjo nuk nenkupton qe biresimi duhet t'i pergjigjet kerkesave te ndryshme te prinderve te mundshem biresues, por qe keta prinder duhet te kene deshire per te pasur nje femije dhe te mund te pranojne femijen qe i jepet. Ne çdo rast **biresimi eshte nje e drejte per minorin** qe ka nevojte per figura prinderore zevendesuese te perhershme. **Nuk eshte e drejte e te rriturve te marrin ne ngarkim nje femije**, sepse e deshirojne kete gje. Shume shpesh perdoret e drejta per barazi e personave per t'i justifikuar çdo personi njohjen e te drejtes per te biresuar me cdo kusht.

Minori qe ka nevojte per nje biresim eshte nje femije qe ka vuajtur per shkak te mangesive te medha.

Keshtu, historia e tij, situata prej biresuesi dhe nganjehere dhe paraqitja e tij fizike e bejne qe ne fillim nje person te ndryshem ne kontekstin social te vendit ose te ambientit familjar ne te cilin eshte parashikuar vendosja e tij. Familja qe do ta prese nuk duhet te keqesoje ndryshimet ose mangesite e tij, por duhet t'i ofroje ose te vleresoje referimet prinderore qe i kane munguar dhe per te cilat ka vuajtur, t'i garantojne nje ambient qe mund t'i lehtësoje integrimin social dhe te jete i afte te perballoje veshtiresi specifike te nje marredhenieje familjare biresuese.

Per keto arsye, Sherbimi Social Nderkombetar mendon, perveç rasteve te vecanta dhe te justifikueshme, qe nje çift, i perbere nga nje burre dhe nje grua dhe me nje moshe ne raport me ate te minorit, ofron nje ambient me te favorshem per zhvillimin e nje minorit. Nderkohe nuk e konsideron te pershtatshme per rritjen e nje minorit nje person te vetem, nje çift personash te te njejtis seks ose nje çift ne moshe te madhe, dhe kur nje nga partneret paraqet nje faktor te veshtire pershtatjeje ndaj nevojave te minorit, ose faktor risku lidhur me kohezgjatjen e mbrojtjes prinderore.

12. Eshte e rendesishme te percaktohet nese personat te cileve i ngarkohet nje i mitur ne biresim, jane ne gjendje te marrin persiper kete pergjegjesi ne interesin primar te te miturit. Familja biresuese **duhet te kete afesine te kujdeset ne menyre te vazhdueshme dhe te kenaqshme per nje te mitur** qe:

- ◆ Eshte i huaj per familjen;

- ◆ Vjen me nje te kaluar te meparshme se takimi i tyre, qe duhet marre ne konsiderate dhe duhet respektuar;
- ◆ Qe ne te shumten e rasteve ka perjetuar situata traumatike si: vdekja ose paaftesia e prinderve per tu kujdesur per te, paqendrueshmeri ne marredheniet e tij me te rriturit, institucionalizim te zgjatur, privime etj. Te gjitha keto burime potenciale per probleme te vecanta;
- ◆ Eshte mbartes, ne vecanti ne biresimin nderkombetar, i nje kulture, i nje gjuhe, i trajtave fizike, sjelljeve te ndryshme etj.

13. Aftesia per biresim i prinderve te ardhshem duhet te verifikohet **perpara** se te vendoset nje bashkim.

14. Aftesia per biresim i prinderve nuk reduktohet ne nje nocion ligjor, ekonomik ose fetar. **Ajo duhet te marre ne konsiderate elemente etike, psikologjike, sociale dhe mjekesore.** Ajo duhet te percaktohet mbi bazen e nje studimi te detajuar psiko-mjeko-social dhe juridik, mbi kandidatet per biresim, i ngarkuar **profesionisteve** ne fushen e mbrojtjes se femijeve dhe te familjes.

15. **Studimi**, me karakter konfidencial, duhet te permbledhe mundesisht informacione mbi:

15.1. Perberjen familjare.

15.2. Situaten civile, ligjore dhe gjyqesore e prinderve potenciale biresues.

15.3. Llojin e diplomes, situaten profesionale dhe ekonomike, vendbanimin, identitetin social, etno-kulturor dhe gjuhesor i prinderve potenciale biresues.

Niveli i studimeve, niveli ekonomik ose statusi i ngritur social i prinderve potenciale biresues, nuk jane nje garanci e mjaftueshme per interesin e minorit. Eshte e nevojshme te vleresohen aftesite psiko - afektive te familjes biresuese ndaj minorit qe mund t'iu ngarkohet, keshtu si edhe vizioni etik ne raport me te drejtat e ketij minorit, duke mbledhur informacione mbi:

15.4. Shendetin fizik, mendor dhe emotiv i çdo prindi potencial biresues.

15.5. Aspektin e pergjithshem, personalitetin e çdo prindi potencial biresues, historine e tij personale, elementet e marredhenieve te tij familjare me prinderit dhe vellezerit e

motrat, te cilet ndihmojne per te kuptuar qe keto raporte mund ta forcojne ose ta pergjojne ne rolin prinderor.

15.6.Historine dhe marredheniet e çiftit.

15.7.Fushat e interesit dhe llojet e integritit ne kontekstin social te çdonjerit prej tyre.

15.8.Mundesite dhe probabilitetet per te patur ne te ardhmen femije biologjike.

15.9.Eksperiencat me femije, aftesite edukative, prirjet per te perballuar veshtiresi qe mund te sjellin diferenca te mundshme midis minorit e ambjentit social dhe familjar.

15.10.Personalitetin e femijeve biologjike te mundshem, llojin e marredhenieve me prinderit, ambjentin dhe sjellja e tyre ndaj projektit biresues.

15.11.Ambjentin social ne te cilin minori biresues duhet te integrohet (familja e zgjeruar-ambjenti social ne te cilin zhvillohet familja-konteksti social) dhe sjelljen e pritshme e minorit, ne veçanti kur eshte mbartes i ndryshimeve ndaj ketij ambjenti; referime mbi mbeshtetjen emotive o te nje lloji tjetër qe prinderit potencial biresues dhe minori mund te presin; veshtiresi te ndryshme.

15.2.Deshiren e prinderve potencial biresues per te patur femije dhe arsyet per te cilat ndonjeri prej tyre shpreson te biresoje nje te mitur.

15.3.Konceptimin e biresimit dhe parimet etike ne kete fushe, ndergjegjia e prinderve potencial biresues per veshtiresite qe mund te hasin ne etapat e ndryshme te jetes se tyre me minorin e biresuar, sjellja e tyre ne raport me jeten e kaluar te minorit, historine e tij, sekretet, diferencat e tij, ne raport me rrefimin e biresimit dhe kerkimin e origjines se tij.

15.4.Tipi i minorit qe prinderit potencial biresues shpresojne te biresojne dhe arsyet perkatese.

15.5.Projektet e prinderve potenciale biresues per te ardhmen e tyre dhe te minorit qe deshirojne te biresojne.

16. Pas studimit, nje ekip, mundesisht multidisiplinar (asistent social, psikolog etj) do te shprehet mbi aftesite biresuese te prinderve potenciale biresues. Ky ekip do te pergatise nje raport te drejtuar organizmave kompetente per bashkim dhe per vendosjen e biresimit. Raporti duhet te jete i kompletuar per te ndihmuar autoritetet kompetente per te ralizuar bashkimin ne interes te minorit e te familjes qe do ta biresoje.

Raporti duhet te permbaje, mundesisht:

16.1. Arsyet për të cilat personat janë quajtur të përshtatshëm t'iu ngarkohet një minor për adoptim. Në rast se bëhet fjalë për një aftësi për biresim ndërkombëtar, arsyet që e justifikojnë duhet të marrin parasysh kërkesa specifike si nevoja për të menaxhuar vështirësi të lidhura me ndryshime fizike, etnike dhe kulturore, traumat e lidhura me institucionalizime të zgjatura e probleme shëndeti.

16.2. Një përmbledhje e informacioneve psiko-mjeko-sociale të mbledhura gjatë studimit mbi prindërit potencial biresues dhe mbi ambjentin e tyre.

16.3. Praktika administrative ose juridike në lidhje me identitetin e tyre, gjendjen civile bashkë me vërtetimin e aftësive biresuese.

16.4. Disa foto të familjes.

16.5. Një përshkrim me koment të pritshmerive të prindërve potencial biresues në raport me biresimin.

16.6. Një vlerësim i elementeve pozitive që në familjen biresuese dhe në ambjentin e saj do t'i garantojë fëmijës një kuader afektiv, moral, edukativ, dhe material të kënaqshëm dhe do të lehtësojë integrimin e minorit. Një vlerësim i limiteve që rrezikojnë t'i kompromentojnë ato në rastin e një biresimi kombëtar e/ose ndërkombëtar. Duke marrë parasysh kompleksitetin e tij, biresimi ndërkombëtar kërkon aftësi më të specifikuar.

16.7. Një vlerësim i aftësive të familjes për t'u kujdesur në vazhdimësi për një minor që mund t'i mos korrespondojë imagjinatës e fantazisë së tyre.

16.8. Një udhëzim orientues mbi tipin e minorit që familja është në gjendje të presë (sjellje, karakter, moshe, veçanti etj.); aftësia e tij për të pritur me shumë motra e vellezer.

16.9. Çdo lloj informacioni tjetër që mund të ndihmojë për realizimin e një bashkimi në interes të minorit dhe të familjes biresuese.

17. Është shumë e rëndësishme që prindërit e ardhshëm biresues të kenë **një përgatitje sistematike dhe të detajuar mbi biresimin**, mundësisht, **përpara** përcaktimit të aftësisë së tyre për biresim që përmban:

- ◆ Princi e etikë në fushën e biresimit dhe e të drejtave të fëmijës në situatë vulnerabiliteti;

- ◆ Informacione mbi biresimin dhe mbi konditat e femijeve te cilet kane nevojte te biresohen ne vende te ndryshme te botes;
- ◆ Etapa, sjellje, zhvillime te mundshme te marredhenies biresuese dhe elemente per ta perballuar ate;
- ◆ Elemente reflektimi per te garantuar nje respekt me te mire te femijes, te kaluares se tij, te origjines, te nevojave, te veçantive, te te drejtave te tij;
- ◆ Nevoja specifike ne biresimin nderkombetar.

Nje perгатitje e mire ndihmon prinderit potenciale biresues te forcohen ne procesin e tyre drejt biresimit. **Perveç kesaj kjo eshte nje mase ne interes te minorit**, sepse zhvillon tek prinderit potenciale biresues nje aftesi me te mire per ta pritur dhe per ta ndjekur gjate gjithte zhvillimit te tij. Si rrjedhoje kjo eshte nje mase **ne interes te te gjithte familjes biresuese**.

BASHKIMI

Bashkimi nuk eshte nje vendim per biresim. Eshte nje propozim per te vendosur nje marredhenie biresuese midis nje femije dhe nje familje te caktuar. Vendimi per biresim do te merret ne nje etape te metejshme.

18. Nje biresim ne interes te minorit eshte ai qe lejon vendosjen e marredhenieve familjare te kenaqshme per te gjithte personat e perfshire: minori, familja biresuese dhe familja biologjike. Bashkimi eshte nje moment kyç, eshte unifikimi i dy projekteve per jete: ai i minorit dhe i familjes se ciles do t`i ngarkohet.

19. Bashkimi duhet te jete **propozimi i nje familje biresuese per nje femije. Ky propozim duhet te jete i pershtatshem** me te kaluares, karakteristikat dhe nevojat e ketij minorit.

20. Bashkimi duhet te vendoset **pasi biresueshmeria** psiko-mjeko-sociale dhe juridike e **minorit te verifikohet** nga profesioniste te sektorit te mbrojtjes se minoreve.

21. Bashkimi duhet te kryhet **pasi** profesioniste te sektorit te femijerise dhe te familjes **te kene vendosur mbi aftesine biresuese** psiko-mjeko-sociale dhe juridike te familjes potenciale biresuese.
22. **Bashkimi duhet t`i ngarkohet nje ekipi** dhe nuk duhet lene ne pergjegjesine e nje personi te vetem. Ky ekip duhet te perbehet nga **profesioniste te sektorit te mbrojtjes se minoreve** dhe te specializuar ne fushen e biresimit. Keta profesioniste duhen mundesisht te jene te specializuar ne lenden psiko-sociale. Ne rastet e biresimeve nderkombetare do te ishte i keshillueshem qe nje jurist te kompletonte stafin me qellim per te verifikuar nese elementet ligjore jane respektuar dhe jane te perputhshem ne vendet e perfshira.
23. Bashkimi nuk duhet lene ne iniciativen e familjes se origjines, pervec rasteve te vecanta te mirejustifikuara dhe te mevonshme ndaj dhenies se vendimit. Ne çdo situatë bashkimi duhet te supervizionohet nga nje sherbim kompetent ne mbrojtjen e minoreve.
24. Bashkimi nuk duhet lene ne iniciativen e pergjegjesve te qendrave pritese, kujdestare ose tutore te minorit, por keta, pasi njohin minorin, brenda mundesive, duhet te integrohen ne brendesi te stafit ose te konsultohen nga vete stafi qe propozon bashkimin.
25. Bashkimi nuk duhet lene ne iniciativen e prinderve potenciale biresues, ne formen e nje perzgjedhje te nje minori midis te tjereve gjate vizitave ne nje institut per femije, gjate vizitave ne familjet e vendit te origjines ose ne nje katalog.
26. Bashkimi nuk duhet lene ne iniciativen e prinderve potenciale biresues nepermjet seleksionimit te nje minori ne nje katalog te ofruar publikisht ne internet.
27. Ne biresimin nderkombetar, bashkimi **eshte nje pergjegjesi e perbashket e profesionisteve e vendit te origjines dhe atij te pritjes**. Sipas mundesive, bashkimi duhet te propozohet pas konsultimit midis subjekteve te meposhteme:

- ◆ Ne vendin e origjines: nje profesionist qe njeh origjinen dhe nje perfaqesues i autoritetit qendror (ose i autoritetit kompetent ose i nje enti te autorizuar);
- ◆ Ne vendin e pritjes: nje profesioniste qe njeh familjen e perzgjedhur dhe nje perfaqesues i autoritetit qendror (ose i autoritetit kompetent ose i nje enti te autorizuar).

28. Perpara se te konfirmohet bashkimi i propozuar duhet t`i nenshtrohet nje aprovimi nga ana e familjes biresuese te perzgjedhur, nga ana i nje prej profesioniste te perfshire ne procesin e biresimit ne vendin e rezidences se familjes.

29. Jo vetem ne interes te minorit por edhe ne ate te familjes biresuese, **eshte e preferueshme qe** perpara se te konfirmohet zyrtarisht, **bashkimi te pasohet nga nje takim i drejtperdrejte**, dhe nese eshte e mundur nga nje periudhe e shkurter njohjeje reciproke midis minorit dhe familjes biresuese.

Eshte e rendesishme qe takimi i pare midis minorit dhe familjes biresuese te jete:

I paraprire nga nje **pregatitje e minorit dhe familjes se ardhshme biresuese** per takimin e propozuar (fotografi, shkembime informacioni, informacione mbi zakonet ose elementet e tjere qe duhen respektuar etj.)

I realizuar ne nje suate te mbrojtur dhe i ndjekur nga persona qe me pare jane kujdesur per femijen.

SUBJEKTE DREJTPERDREJT TE PERFSHIRA NE PROCESIN E BIRESIMIT

Jane quajtur subjekte ato organizma ose persona qe kane nje rol ne procesin e biresimit, cilado qofte rendesia dhe niveli i nderhyrjes.

1- Autoriteti qendror ne fushen e biresimit kombetar e/ose nderkombetar (CHL.n.6)

Autoritete te tjera kompetente qeverisese dhe gjygesore (CHL.n.7,8,9)

2- Organizma te autorizuar kombetar te vendeve pritese – te vendve te origjiues (CHL.n.10.11.12)

3- Organizma ose persona jo te akredituata por qe perfitojne nga nje njohje zyrtare (ne kuadrin e Konventes se Hages) per te nderhyre ne fushen e biresimeve (CHL.n.22 – 2). Keta nuk jane te detyruar t`iu pergjigjen te gjitha kerkesave te nevojshme te organizmave te akredituara (midis te tjerave te mos jene per qellime perfitimi). Nje shtet pjese e CHL mund te refuzoje qe keta subjekte te marrin pjese ne procesin e biresimit (ne momentet qe duhet te realizohen ne vendin e tyre ose ne vendet e tjera te perfshira) kur ky proces perfshin persona rezident ne territorin e tij.

4- Organizma dhe persona qe nderhyjne ne procesin e biresimit pa qene te akredituar ose pa patur nje njohje zyrtare qe t`i autorizoje per kete (ne kuadrin e Konventes se Hages), pa shkelur ligjin ose rregullat administrative te vendit (te vendit te tyre ose te vendit tjeter te perfshire), por qe jane jashte asaj qe eshte parashikuar nga CHL.

5- Organizmat dhe personat qe nderhyjne ne procesin e biresimit pa qene te akredituar ose pa patur nje njohje zyrtare qe t`i autorizoje per kete (ne kuadrin e Konventes se Hages) kur ky rezulton kunder ligjit ose rregullave administrative te vendit (te tyre ose te vendit tjeter te perfshire).

Konventa e Hages e vitit 1993 mbi mbrojtjen e femijeve dhe mbi bashkepunimin ne fushen e biresimit ndekombetar parashikon subjektet e pershkruara me siper nga pika 1 tek 3. Subjektet me numer 4 e 5 nuk jane te pranuar nga Konventa.

Sherbimi Social Nderkombetar e konsideron themelore nderhyrjen e organizmave te cituar ne numrat 1 e 2 dhe, midis tyre dhe organizmave te cilat kane nje staf te perbere nga profesioniste ne fushen e mbrojtjes se minoreve, me perberje multidisiplinare (punonjes social, psikolog, jurist), te cilet kane perfiturar nga nje formim specifik ne fushen e biresimit si e drejte e femijeve dhe qe te jene te udhehequr nga nje etike e drejtuar nga interesi primar i femijes.

SHSN nenvizon qe te paturit e eksperiences se prindit biresues nuk eshte nje kualifikim i mjaftueshem per te nderhyre ne procedurat e biresimit. Si nje ent profesional, pervec te tjerave, duke njohur dhe vleren e padiskutueshme te vullnetarizmit, Sherbimi Social Nderkombetar ve ne dukje se nuk mund te konsiderohet ne vetvete si nje kompetence dhe te jete i autorizuar per te zevendesuar kualifikime specifike profesionale ne mbrojtjen e femijes.

Sherbimi Social Nderkombetar eshte dakort me nderhyrjen e organizmave te akredituara ne biresimin ndekombetar (te cituara ne piken 2), ne vecanti ne vendet prites, pasi sigurojne lidhjen konkrete rast per rast midis vendit te origjines dhe vendit prites, midis minorit dhe familjes se origjines, midis territorit dhe nivelet e larta qeverisese.

Megjithate, ne interes te minorit, Sherbimi Social Nderkombetar, insiston ne:

- ◆ **te behen me te rrepta kriteret e akreditimit;**
- ◆ **t'i jepet karakter sistematik metodologjise se akreditimit;**
- ◆ **te favorizohet trajnimi dhe perditimi i ketyre organizmave ne fushen e te drejtave te femijeve dhe te biresimit;**
- ◆ **te permiresohet supervizionimi i tyre periodik;**

Pa dashur te ulim vleren sherbimit vullnetar, Sherbimi Social Nderkombetar rekomandon qe organizmat e akredituara te disponojne, mjete materiale te mjaftueshme per te

punesuar personel te kualifikuar profesionalisht, me qellim per te siguruar formimin e tij ne fushen e biresimit dhe te drejtave te femijeve, per te organizuar punen e tij ne menyren e duhur dhe per te siguruar nje mbrojtje reale te femijeve.

Duke marre ne konsiderate qe nje pjese e detyrave te kryera nga organizmat e autorizuar jane te deleguara nga Shteti. Ky i fundit duhet te garantohet, ose mundesisht te mbeshtese, qe ata te mund te kene burime dhe kualifikime te mjaftueshme.

Sherbimi Social Nderkombetar eshte vendosmerisht kunder perfitimeve ose fitimeve materiale te padrejta ose te ekzagjeruara ne menyre te dukshme ne kuadrin e biresimit. Mbrojtja e minoreve ne kushte veshtiresie nuk duhet te kthehet ne nje burim fitimi ose te mirash materiale te ndonje natyre tjeter.

Sherbimi Social Nderkombetar konsideron te domosdoshme qe te propozohen me shpejtesi dhe qe te perditoen periodikisht ne nivel nderkombetar dhe kombetar si ne vendet pritese dhe ne ato te origjines:

- ◆ nje liste te pikave ne procesin e biresimit, ose te lidhura me biresimin qe mund te jene subjekte pagese;
- ◆ kuota minimale dhe maksimale e shperblimeve, shpenzimeve dhe e çmimeve te sherbimeve ne fushen e biresimit, te cilat mund te konsiderohen te arsyeshme.

SHERBIMI SOCIAL NDERKOMBETAR

STRUKTURA

21 Zyra Rajonale: Shqiperia, Argjentina, Australia, Kanada, Kina dhe Hong Kong, Finlanda, Franca, Gjermania, Japonia, Greqia, Izraeli, Italia, Zelanda e Re, Vendet e Ulta, Portugalia, Anglia, Spanja, Shtetet e Bashkuara te Amerikes, Afrika e Jugut, Zvicra, Venezuela.

140 Korrespondente: ne zona te ndryshme gjeografike.

Sherbimi Social Nderkombetar eshte nje organizem i lindur ne Gjeneve me 1924 i cili pa diskriminim politik dhe fetar, vepron me ndihmen e punonjesve sociale profesionale per te zgjidhur probleme individuale dhe familjare te cilat kerkojne nje nderhyrje jashte shtetit. Sherbimi Social Nderkombetar ka statusin keshillues prane organizmave te ndryshme te OKB (ECOSOC, UNICEF, UNHCR, UNESCO), te Keshillit te Europes, Konferences se Hages per te Drejtat Nderkombetare Private dhe Asocimin e Shteteve Amerikane.

QELLINE

- Koordinon nderhyrjet e sherbimit social ne vende te ndryshme per te zgjidhur probleme socio-juridike qe rrjedhin nga paqendrueshmeria e personave.
- Ndhmon ata te cilet per shkak te nje migrimi te detyruar ose te vullnetshem, duhet te kalojne veshtiresi personale ose familjare qe kerkojne nje nderhyrje sociale ne vendin ku qendrojne ose nje nderhyrje te koordinuar ne shume vende.
- Zhvillon projekte ne favor te emigranteve, te imigrateve, te refugjateve dhe te minoreve te huaj te pashoqeruar.
- Kujdeset per programe nderkombetare dhe kombetare per te parandaluar ndarjen e familjeve ose per te ribashkuar familje te ndara.
- Sensibilizon organizma nderkombetare dhe autoritete kombetare per te parandaluar veshtiresite personale, familjare dhe sociale, si per shembull ato qe lindin nga ndryshimi i gjuhes, kultures, zakoneve dhe ligjeve.
- Promovon kerkime mbi zhvillimin e migracioneve dhe pasojat e tyre.
- Kryen studime mbi nje plan me te pergjithshem me qellim per t'iu sugjeruar organizmave te ndryshem nderkombetare udhezime te nevojshme per programimin e nderhyrjeve ndihmese qe interesojne me shume vende.

Seksioni Italian, Enti Moral, ONLUS, vepron qe nga 1932 me seli ne Rome.

Rruga: Vittorio Veneto, 96 – 00187 Rome
Tel.: 0039/06 4884640 – fax.: 0039/06 4817605
E – mail: issitaly@tin.it
Web Site: www.issitaly.org

